



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0651

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D. Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Kimete Gashi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtruar nga Operatorët Ekonomik “ITK” SH.P.K dhe “TSR” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi vertikal dhe horizontal”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrrise, me datën 23.09.2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohen, si pjeserisht të bazuara ankesat e Operatorit Ekonomik “ITK” SH.P.K.. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me dt. 14.07.2025 me nr. protokolli 2025/0651 dhe ankesa e Operatorit Ekonomik “TSR” SH.P.K. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me dt.14.07.2025 me numër protokolli 2025/0652 për aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi vertikal dhe horizontal” me nr. të prokurimit:”VU644-25-3798-1-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna e Vushtrrise.

2. Anulohet njoftimi mbi vendimin e AK lidhur me aktivitetin e përshkruar si në pikën 1 të këtij dispozitivi dhe lënda kthehet në rivlerësim.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 05.05.2025, Komuna e Vushtrrise në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi vertikal dhe horizontal” me numër të prokurimit: ”VU644-25-3798-1-1-1”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 350,000.00 €.

Me 24.06.2025 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë OE: Traffiks VA SH.P.K.

Me 30.06.2025, OE “ITK” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me datë 29.06.2025 po ashtu edhe OE “TSR” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 08.07.2025, Autoriteti Kontraktues ka publikuar një vendim përmes të cilit hedhen poshtë si te pa bazuara ankesat e te dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me datë 15/07/2025 edhe OE “ITK” SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 2025/0651

Ndërsa, me 14/07/2025, OE “TSR” SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 2025/0652

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, OSHP ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 651/25 dhe ankesa nr. 652/25 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ITK” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi 1:

Pretendimi ynë ka të bëjë me vendimin e Autoritetit Kontraktor (AK) dhe arsyet që ata përdorën për eliminimin tonë nga aktiviteti i prokurimit, të cilat i kanë arsyetuar si më poshtë:

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka konstatuar se OE I.T.K. SH.P.K. ka paraqitur tenderin në mënyrë të papërshtatshme. Në këtë mënyrë, ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk

ka qenë i suksesshëm, pasi tenderi juaj nuk plotëson kërkesat formale/administrative të përcaktuara në "Dëshmi e Tenderit" mbi kërkesat teknike dhe/ose profesionale, siç përcaktohet në nenet 9.1 dhe 9.2, kërkesa 1 dhe 5, në ofertën e tenderëve që plotësojnë kërkesat e dhëna në ujoitimin e kontratave dhe në dosjen e tenderit.

Kjo është bërë në kundërshtim me Instruksionet për Prokurimin Publik (IPP), duke anashkaluar kërkesat e Fletës për Detajimin e Tenderit (FDT), sipas të cilave është kërkuar:

Kërkesa

1:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të punëve të natyrës së njëjtë gjatë 3 (tre) viteve të fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi për Kontratë. Vlera totale e kontratave të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, kanalizimit duhet të jetë minimumi 500,000 EUR (pesëqind mijë EUR). Dëshmia duhet të përfshijë listën e kontratave të natyrës së ngjashme për tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke bashkëngjitur kopjet e kontratave dhe referencat ose procesverbalet e pranimeve teknike për kontratat e prezantuara në listë, në vlerën e kërkuar.

AK, më datën 09.06.2025, pas kërkesave për sqarim nga OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, ka publikuar sqarimin në sistemin e e-prokurimit, ku ndër të tjera ka sqaruar këtë pjesë, dhe atë si më poshtë:

Pyetje 3 – Kërkesat teknike dhe profesionale:

"Çfarë është kërkuar nga operatorët ekonomikë për të ofruar dëshmi se kanë përfunduar kontrata të natyrës së njëjtë në tri vitet e fundit?"

Përgjigje: "Kërkohej të ofrohet dëshmi se kontratat kanë të bëjnë me punë të natyrës së njëjtë me ndërtimin e ujësjellësve dhe kanalizimeve, ku vlera totale e kontratave duhet të jetë të paktën 500,000 EUR."

Pavarësisht sqarimeve, AK nuk ka publikuar formularin për korrigjimin e gabimeve, gjë që ka krijuar konfuzion jo vetëm për anëtarët e komisionit brenda AK-së, por edhe për të gjitha palët e interesuara në këtë procedurë.

Në kërkesën për rishqyrtim, ne kemi paraqitur ndryshimet që janë bërë gjatë fazës së procedurës, të cilat janë publikuar në e-prokurim, por që AK i ka anashkaluar qëllimisht, pa dhënë asnjë argument. Për më tepër, në mënyrë të qëllimshme dhe për të krijuar konfuzion, AK i është referuar të gjitha pretendimeve tona me një deklaratë të pakuptimtë dhe të përgjithshme, pa hyrë në thelb të tyre.

Ne, si OE i përgjegjshëm, kemi bashkëngjitur listën e projekteve të realizuara, e cila jo vetëm që i përmbush, por edhe i tejkalon kërkesat e përcaktuara nga AK. Megjithatë, kjo listë nuk është marrë fare parasysh gjatë vlerësimit.

Në listën e projekteve të bashkëngjitur ofertës sonë, kemi përfshirë kontrata të përfunduara me vlerë 519,356.48 EUR, që përmbushin plotësisht kërkesën e përcaktuar në FDT. Kjo do të thotë që nuk është përfshirë as kontrata me vlerë 304,702.73 EUR, e cila është brenda afateve të kërkuara në dosjen e tenderit.

Pavarësisht kësaj, AK ka vendosur të na shpallë të papërgjegjshëm, pa asnjë bazë ligjore.

Më poshtë paraqesim dëshmitë përkatëse, të cilat janë pjesë e ofertës sonë:

(Bashkëngjitur janë edhe dokumentet përkatëse dhe listat me projektet.)

Bashkëngjitur ju dërgojmë edhe listën me projektet, të cilat është dashur të merren parasysh gjatë vlerësimit, por që nuk janë shqyrtuar fare.

Po ashtu, AK gjatë vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të neneve 1, 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke na diskriminuar si OE i përgjegjshëm dhe duke bërë vlerësimin e ofertës sonë në kundërshtim të plotë me nenin 59 të LPP-së.

AK ka injoruar çdo dëshmi dokumentuese të bashkëngjitur në ofertë, si dhe vetë sqarimin e dhënë gjatë aktivitetit të prokurimit. Për më tepër, edhe pas kërkesës për rishqyrtim, AK nuk e ka shqyrtuar fare kërkesën, por ka dhënë një përgjigje që nuk ka asnjë lidhje me ato që kemi pretenduar ne.

Si pasojë, AK gjatë përgjigjes në kërkesën për rishqyrtim dhe në marrjen e vendimit ka shkelur edhe nenin 108A të LPP-së, duke mos i dhënë përgjigje asnjëra nga pretendimet tona.

Pretendimi 2:

Sa i përket pretendimit të dytë, i cili ka të bëjë me arsyen e eliminimit nga AK, ne jemi eliminuar me arsyetimin se nuk kemi plotësuar kërkesën 5 të nenet 9.1 dhe 9.2, e cila ka të bëjë me:

Kërkesa 5:

- Certifikatat ISO 9001:2015 për Menaxhimin e Cilësisë;
- ISO 39001:2012 për Menaxhimin e Sigurisë së Trafikut Rrugor.

Certifikatat duhet të jenë valide (Në rast të ofruesve të Grupit të Organizatave Ekonomike (GOE), ato duhet të dorëzohen në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik për secilin anëtar të grupit).

Dëshmia:

Certifikatat valide ISO 9001:2015 për Menaxhimin e Cilësisë; Certifikatat ISO 39001:2012 për Menaxhimin e Sigurisë së Trafikut Rrugor.

Ne, si operator ekonomik, kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë në përputhje me kërkesat e FDT-së, duke përfshirë të gjitha certifikatat ISO të kërkuara, të cilat janë të dokumentuara dhe të verifikueshme, siç është paraqitur më poshtë dhe janë pjesë e ofertës sonë:

(Lidhur me detajet teknike të certifikatave, mund të futen informacionet përkatëse këtu.)

Ne nuk e kemi të qartë se si komisioni ka arritur në përfundimin se nuk e plotësojmë këtë kërkesë, pasi të gjitha dëshmitë janë paraqitur qartë, të dokumentuara dhe lehtësisht të verifikueshme. Kjo kërkesë është përmbushur plotësisht nga ana jonë.

Për të dytën herë, si në pretendimin e parë, ne konsiderojmë se komisioni i vlerësimit ka vepruar në mënyrë subjektive gjatë procesit të vlerësimit, duke shkelur dispozitat e nenet 1, 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), si dhe nenin 40 të Rregullores nr. 002/2024 për Prokurimin Publik (RRPP).

Si rezultat, ne jemi diskriminuar si operator ekonomik i përgjegjshëm, ndërkohë që është favorizuar në mënyrë të hapur OE i renditur i dyti, megjithëse ka paraqitur një ofertë me çmim më të lartë. Kjo përbën një përpjekje të qartë dhe të papranueshme për të na dëmtuar, në kundërshtim me parimet dhe normat ligjore të aplikueshme.

Për më tepër, në vendimin lidhur me kërkesën për rishqyrtim, AK ka pretenduar se ne kemi paraqitur pretendime jashtë dispozitave ligjore dhe rregulloreve të prokurimit publik. Një arsyetim i tillë është i pakuptimtë dhe i paarsyeshëm, pasi nuk mund të kuptohet se si një qëndrim i tillë mund të përbëjë argument ligjor, sidomos kur pretendimet tona kanë qenë të qarta dhe të mbështetura me dëshmi konkrete.

Një përgjigje e tillë nuk mund të shihet ndryshe veçse si tentativë për të na diskriminuar si operator ekonomik të përgjegjshëm, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Pretendimi 3:

Pretendimi ynë i tretë ka të bëjë me ofertën e operatorit ekonomik (OE) të rekomanduar për kontratë, e cila, në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), është rekomanduar për kontratë edhe pse është me çmim më të lartë se ne dhe nuk ka ofruar ofertë të përgjegjshme.

Sipas Fletës së Tenderit (FDT), për Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë kërkuar:

C) Një Ekspert për Mbrojtjen e Mjedisit, i certifikuar me ISO 14001:2013, me minimum 3 vite përvojë pune dhe angazhime profesionale pas certifikimit.

D) Një Ekspert në Menaxhimin e Emergjencave, i certifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës. Ky ekspert duhet të posedojë edhe certifikatën për Siguri dhe Shëndet në Punë dhe të ketë minimum 5 vite përvojë pune dhe angazhime profesionale pas certifikimit.

Dh) Një Lead Auditor sipas kërkesave të standardeve ISO 9001:2015 (për Menaxhimin e Cilësisë).

Sipas kërkesave të FDT-së, janë kërkuar katër (4) ekspertë të veçantë. Nga ta, eksperti për Menaxhimin e Emergjencave është lejuar të posedojë edhe certifikatën për Siguri dhe Shëndet në Punë. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar këtë certifikatë, por përkundër faktit që ishte e nevojshme të ketë tre ekspertë për tre kërkesa të veçanta, ai ka dorëzuar vetëm një ekspert. Kjo do të thotë se nuk është plotësuar kërkesa në mënyrë të duhur, siç tregohet më poshtë:

Emri	Pozicioni/Certifikimi	Përshkrimi
Vehbi Goxhuli	Ekspert për Mbrojtjen e Mjedisit, ISO 14001:2013	Ekspert për Menaxhimin e Emergjencave, Master i Shkencave Teknike, Inxhinieri i Mbrojtjes së Mjedisit
	Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë	Lead Auditor ISO 9001:2015

Megjithëse është kërkuar që OE të ketë tre ekspertë të fushave përkatëse sipas kërkesave të FDT-së, në asnjë nen të FDT-së apo sqarim shtesë nuk është lejuar që kjo kërkesë të plotësohet nga vetëm një ekspert.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues (AK) e ka konsideruar si të pranueshme një interpretim të tillë, duke shkelur nenin 40 të Rregullores nr. 002/2024 për Prokurimin Publik (RRPP) dhe duke diskriminuar të gjithë operatorët e tjerë ekonomikë të interesuar në këtë aktivitet prokurimi.

Duke mos e sqaruar në kohë këtë çështje, AK i ka mundësuar vetëm një OE-je të konsiderohet si i përgjegjshëm, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara nga vetë AK.

Pretendimi lidhet edhe me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht me:

Kërkesa 10: Lista e mjeteve të domosdoshme për realizimin e projektit sipas Aneksit 8.

Dëshmia 10: Duhet të prezantohen kopjet e dokumenteve të regjistrimit të paisjeve - librezat valide të qarkullimit rrugor, dokumentet unike doganore ose faturat e blerjes. Në rast se OE nuk posedon paisjet në pronësi, atëherë duhet të prezantohet marrëveshje për shfrytëzimin e paisjeve në emër të këtij projekti, e nënshkruar nga të dy palët, me kohëzgjatje sa projekti dhe dëshmitë e librezave valide të qarkullimit rrugor, dokumentet doganore ose faturat e blerjes.

OE i rekomanduar për kontratë ka bashkëngjitur një kontratë për marrje me qira nr. 2870 kol. 724 me OE Albanian Traffic Solutions për dy pajisje:

1. Makineri speciale për lyerjen me ngjyrë me bazë plastike dhe të ngjashme, që nuk dëmton shtresat qarkulluese të asfaltit, referencë doganore R158676.
2. Makineri për vëtvëçsimin e pashive elastike - TURQI, Mod: 26Q/F 950, Nr. Ser.: 077 4D4 032, referencë doganore R37371.

Paisja me numrin rendor 2, që i referohet numrit doganor R37371, nuk është në përputhje me kërkesat e FDT-së, pasi nuk dëshmohet me dokument doganor (DUD) se është doganuar në emër të palës që e ka dhënë me qira.

Si rrjedhojë, kjo paisje nuk është pronë e OE Albanian Traffic Solutions dhe është në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Komisioni është dashur ta eliminojë këtë ofertë nga procedura, dhe jo ta favorizojë në dëm të ofertës sonë, e cila është e përgjegjshme dhe ka çmimin më të ulët.

Si rezultat, ne vlerësojmë se AK gjatë vlerësimit të ofertës sonë ka shkelur nenet 7 dhe 59 të LPP-së, si dhe nenin 40 të RRPP-së, dhe gjatë rekomandimit për kontratë nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “TSR” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi 1

TENDERUESI I REKOMANDUAR “TRAFFIKS VA SHPK” KA OFERTUAR ME ÇMIME JONORMALISHT TË ULËTA (te sit. A poz. 3, 4, 5, 6,7 dhe te sit. B poz. 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12).

Tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmimin total të peshuar prej 78.58 euro. Në këtë aktivitet të prokurimit janë dorëzuar gjithsej 4 oferta, prej të cilave 3 janë gjetur nga AK si të përgjegjshme (sipas AK) dhe 1 është e papërgjegjshme. Mesatarja e çmimit nga 3 ofertat e përgjegjshme është 118.33 euro. Oferta e dytë pas tenderuesit të rekomanduar është me çmim prej 132.80 euro. Pra oferta e tenderuesit të rekomanduar është dukshëm më e lirë sesa 30% e mesatares së tri ofertave të përgjegjshme dhe dukshëm më e lirë sesa 10% e ofertës pasuese më të lirë.

Përmes nenit 41 par. 3 të RRPP përcaktohet si vijon “*Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme : i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë*”. Në rastin konkret AK ka shkelur në mënyrën më flagrante të mundshme nenin 41. par. 3 të RRPP pasi që nuk e ka eliminuar si të papërgjegjshëm tenderuesin e rekomanduar por e ka shpërblyer me kontratë.

Çmimi më i lirë në treg aktualisht për masë plastike të ftohtë 2K (për sinjalizim horizontal) 1kg është 1.88 euro. Me një kalkulim shumë të thjeshtë, kur marrim parasysh që trashësia është kërkuar 3mm, atëherë për një të tillë kemi shpenzime rreth 6 Kg masë Plastike të ftohtë 2K metër katror ($6 \times 1,8 = 10,8$ euro vetëm material pa punë dhe shpenzime tjera) ndërsa oferta e këtij OE te poz. 3 është maksimumi 4.00 euro. Për m^2 Në anën tjetër masa e ngrohtë termoplastike, çmimi aktual në treg për cilësinë më të dobët të mundshme është min. 0.89 euro për 1 kg. Mirëpo përtej çmimit të furnizimit, duhet shtuar edhe koston e transportit, pastaj punën e dorës, shpenzimet e pajisjeve dhe shpenzimet tjera operative, TVSH, etj.

Tenderuesi i rekomanduar në poz. 3 të paramasës ka ofertuar me çmimin prej 4,00 euro që parimisht nuk mund të mbuloj as koston e furnizimit. Pra është absolutisht e pamundur që poz. 3 i paramasës të realizohet me një çmim të tillë. Ngjashëm vlen edhe te pozicioni 7 kutenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmimin prej 1,5 euro për m^2 , as ky pozicion nuk ka mundësi teorike apo praktike që të realizohet me sukses dhe sipas DT me një çmim të tillë.

Kjo pasi që edhe këtu kërkohet ekzekutimi i me masë plastike ose masë plastike me 2 komponentë të ftohtë ose termoplastikë, duke marrë parasysh që për një punë të tillë në qoftëse ekzekutojmë me një trashësi minimale 1 mm çka do të ishte jashtë normave përsëri do të kemi shpenzime $1m^2$ ($1 m^2 = 2kg$ material $\times 1.8$ euro $= 3.6$ euro me minimum trashësi dhe pa shpenzime siç janë punëtorët derivatet tvsh, ndërsa në qoftë se ky poz. realizohet me termoplastikë atëherë kemi $1m^2 = 2-3mm$ trashësi minimumi kemi 5 kg $1m^2 \times 0.89 = 4,45$ pa transport pa tvsh pa ekzekutim dhe pa shpenzime tjera ndërsa për qudi AK e pranon çmimin e këtij OE me 1.5euro për metër katror dhe autoriteti kontraktues as që ka kërkuar sqarime në kuptim të nenit 41 të RRPP lidhur me çmimet jonormalisht të ulëta Problemi me çmimet e ofertuara nga tenderuesi i rekomanduar është shumë më i madh sesa kaq. Nuk janë vetëm çmimet jonormalisht të ulëta që janë ofertuar në poz. 3 dhe 7. Ky tenderues në poz. 1 ka ofertuar me çmimin prej 39.96 euro për $1/m^2$. Ngjashëm edhe te poz. 8 është ofertuar çmimi prej 35 euro për $1/m^2$. Prandaj nëse analizojmë me kujdes këto diskrepanca kaq të mëdha (kur dihet se janë çmime me produkte/material të njëjta si te poz 3 dhe 7), natyrisht që lind dilema se cilat janë arsyet që tenderuesi i rekomanduar apo ndoshta ky tenderues ka pasur njohuri para ofertimit për poz. të cilat fare nuk do të ekzekutohen. Ky tenderues te poz. i sinjalizimit Horizontal poz. 3 dhe 7 po

ashtu oferton me çmime jonormalisht të ulëta .

Tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmime tendencioze dhe qesharake edhe te sit. B. Tash e sa vite që punojmë në këtë treg, asnjëherë nuk kemi parë dhe as nuk kemi dëgjuar që një OE të ofertoj shenjë e komunikacionit me 1.5 euro. Më konkretisht tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar një shenjë të plotë të komunikacionit me të gjithë aksesoret e nevojshëm (hekur apo alumin adezivi, folje, lidhëset dhe montimi) me një çmim qesharak për vetëm 1.5 euro. Në fakt ky çmim është ofendim edhe për inteligjencën prandaj është shumë e çuditshme pse AK nuk e ka vërejtur një detaj të tillë. Nëse AK do të merr mundin që të verifikojë dudat doganor të importit nga tenderuesi i rekomanduar apo cilido OE tjetër që merret me këtë punë, atëherë mund të konfirmohet se çmimi aktual i tregut vetëm për materialin e nevojshëm është nga 10 deri në 30 euro, pastaj çmimi i adezivit është 7.5 euro për metër katror. Pra minimalisht 20 euro janë vetëm kosto e furnizimit, pa aksesoret shtesë (pallat e hekurit apo aluminit, lidhëset, etj), punën e dorës, TVSH, etj.

Tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët edhe te poz. 12 për pahit elastike ku ky OE ka ofruar çmimin prej 1 euro për metër (me montim, me këmbë dhe të gjitha punët tjera). Këtu AK e ka shumë të lehtë të konfirmojë se sa kushton ky material në tregun e Kosovës. Si shembull, një prodhues i këtij materiali ndodhet në Viti. Çmimi aktual në treg i këtij produkti vetëm për furnizim sillet nga 23 deri në 2 euro për m (pa ekzekutim dhe shpenzime shtesë). Prandaj çmimi prej 1 euro me të cilin ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar jo vetëm që është jonormalisht i ulët dhe është absolutisht e palogjikshme kur kemi parasysh faktin se çmimi i ofruar nuk mjafton as për skrap (mbeturina të hekurit) që aktualisht në treg sillet nga 0.80 euro për kilogram ndërsa një shenjë e komunikacionit ka së paku $3,5 \text{ kg} \times 0.80 = 2.80$ euro. Pra nuk ekziston asnjë shpjegim logjik apo teorik që tenderuesi i rekomanduar të mbulojë këtë pozicion me vetëm 1 euro.

Tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët edhe te poz. 10 –*“Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) së pasqyrës për rritjen e dukshmërisë, pasqyra duhet të jetë fi 80 cm”*. Dihet se në RKS nuk ka prodhues të këtij produkti prandaj duhet të importohet nga vendet tjera. Aktualisht çmimi i tregut për këtë produkt është rreth 35 euro për copë.

Ne do të mund të kishim mirëkuptim nëse tenderuesi i rekomanduar do të kishte ofertuar çmime jonormalisht të ulëta për 1 ose 2 pozicione, por jo në të gjitha këto produkte dhe pozicione (gjithsej 13 poz. apo përafërsisht 50% të paramanës pasi që përpos këtyre poz. ka edhe poz. tjera ku mbulohet vetëm çmimi i blerjes). Në fakt paradoksi qëndron se si AK nuk i ka vërejtur këto fakte gjatë vlerësimit të ofertave. Mbi të gjitha është për t'u çuditur se si AK nuk e ka vërejtur rrezikonin që nëse lidhet kontrata me këtë ofertues, i njëjti mund të ekzekutojë vetëm pozicionet që janë me çmime ekstremisht të larta dhe të mos ekzekutojë fare pozicionet me çmime jonormalisht të ulëta, duke e dështuar kështu në tërësi projektin.

Tenderuesi i rekomanduar te sit. A i ka gjithsej 5 pozicione me çmime jonormalisht të ulëta.

Po ashtu edhe te sit. B janë edhe 8 pozicione tjera me çmime jonormalisht të ulëta me të cilat nuk mund të mbulohet as kosto e furnizimit dhe lëre më ekzekutimi. Të gjitha pozicionet me çmime jonormalisht të ulëta nga sit A dhe B (13 poz. gjithsej) janë si në vijim:

Pretendimi nr. 2 – kërkesa 8 e DT është si vijon “Katalogu i produkteve i cili duhet të jetë i njëjti nga autorizimi original i prodhuesit apo distributorit të autorizuar“. Tenderuesi i

rekomanduar nuk e ka dorëzuar katalogun origjinal të produkteve të prodhuesit por e ka dorëzuar një katalog të hartuar vet kinse të përkthyer. Në këtë rast OE është dashur që të dorëzojë përpos versionit të përkthyer edhe katalogun origjinal për të konfirmuar nëse përkthimi është autentik. Në të kundërtën katalogu i dorëzuar nga OE në versionin siç është nuk e përmbush kërkesën e DT sepse nuk konfirmon nëse katalogu është sipas prodhuesit të autorizuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16.07.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr.651/2025&652/2025, ndërsa me datë 28.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/651&2025/652 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK Pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa OE ITK SH.P.K. është deklaruar se pajtohet lidhur me mendimin e ekspertit. Kurse OE TSR SH.P.K. nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “ITK” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/651 kanë vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Sinjalizimi vertikal dhe horizontal” me nr. të prokurimit: "VU644-25-3798-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E VUSHTRISË, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, në të cilin vendim OE ankues është eliminuar me arsyetimin:

“Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj nuk plotëson-Kërkesat formale/administrative të përcaktuara në Dosje të tenderit te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1&9.2 kërkesa 1 dhe 5, në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”

Në këtë mënyrë ju si operator ekonomik nuk keni regjistruar këto kërkesa dhe për pasojë keni devijim thelbësor nga kërkesat e përcaktuara dhe specifikimet e detyrueshme gjegjësisht keni bërë devijim qenësor-thelbësor nga kërkesat e tenderit, gjë që ka bërë që vlerësimi për rregullshmërinë e dëshmive të dorëzuara lidhur me kërkesat Administrative të mos të jetë i plotë, i rregullt dhe i pranueshëm.

Andaj, në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe Rregullave për prokurim publik në Kosovë tenderi juaj është refuzuar.”

Tuje, OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtroi ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK ofertat ka vlerësuar në kundërshtim me nenet:1,7,59 të Ligjit për Prokurim Publik si dhe nenin 40 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022.

Në ankesë janë parashtuar pretendimet ankimore kundër arsyes së eliminimit si dhe kundër operatorit ekonomik (OE) të rekomanduar.

Pretendimi i parë i OE ankues kundër AK-së:

OE ankues pretendon se AK nuk ka arsyetuar eliminimin por vetëm sipërfaqësisht eliminon të njëjtit, për faktin se lista e projekteve tejkalon vlerën e kërkuar dhe se pretendojnë që plotësojnë kërkesën 9.1&9.2 të DT-së.

(vërejtje: pretendimin ankimor të plotë e gjeni tek depozitat ligjore dhe pretendimet ankimore të OE ankues lartë në raport të ekspertit)

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues kundër arsyes së eliminimit:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës në E-prokurim sqaron se, AK në DT kërkon:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me Sukses kontrata të punëve të natyrës së njëjtë gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës. Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, kanalizim të jetë minimumi i vlerës prej 500,000,00 EUR (shtatëqind mijë).

Dëshmia Lista e kontratave të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, të bashkangjitura me kopje të kontratave dhe referenca ose procesverbalet e pranimeve teknike për kontratat e prezantuara në listë në vlerën e kërkuar.

Kurse gjithashtu në kuadër të këtyre kërkesave, bazuar në E-prokurim, AK në sqarim të kërkesave nga Operatorët ekonomik, i njëjti ka sqaruar se është gabim teknik, mirëpo konform nenit 24.5 të Rregullore për Prokurim Publik nr.001/2022, sqarimet nga AK janë dhënë me datë 30/05/2025 ndërsa hapja e ofertave është realizuar me datë 16/06/2025 atëherë i bie më tepër se 10 ditë, **andaj nuk ka qenë e nevojshme që të shtyhet afati për dorëzim të ofertave.** citat:

*“24.5 Nëse, gjatë një procedure të hapur, të kufizuar apo konkurruese me negociata, informata shtesë apo sqaruese ofrohen për OE-të, **dhe data kur ofrohen këto informata është më pak se dhjetë (10) ditë** nga afati i fundit për dorëzim të tenderit, AK do të zgjatë afatin kohorë për të dhënë mundësi OE të paktën 10 ditë për dorëzimin e tenderëve duke përgatitur dhe publikuar Njoftimin për korrigjim të procedurës”*

Gjithashtu, përgjigja e Autoritetit Kontraktues ndaj refuzimit të kërkesës për rishqyrtim është e pakuptimtë duke mos arsyetuar refuzimin e kërkesës konform nenit 108/A par.9 të LPP-së.

Ndërsa, lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues bazuar në raportin e komisionit të vlerësimit ekspertja shqyrtuese konsideron se, OE ankues e plotëson kërkesën për projektet e përfunduara në sinjalizim (natyrë e njëjtë) së bashku me dëshmitë e ofruara në ofertë, për faktin se, i njëjti posedon projektet sinjalizim në vlerë mbi 900K, kurse nëse marrim parasysh vetëm dy projekte nga MMPHI me referenca, kontratat, tejkalojnë vlerën 605 K. (Dëshmitë gjenden në faqe 37 dhe

faqe 95 në folderin “Projekte të realizuara me kontratat dhe referenca”). Pretendimi i OE ankues gjendet i qëndrueshëm.

Pretendimi i dytë i OE ankues kundër AK-së:

OE ankues pretendon se AK lidhur me ISO standardet nuk ka vlerësuar drejtë, sepse të njëjtit i posedojnë në ofertë dhe e plotësojnë kërkesën.

(vërejtje: pretendimin ankimor të plotë e gjeni tek depozitat ligjore dhe pretendimet ankimore të OE ankues lartë në raport të ekspertit)

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues kundër arsyes së eliminimit:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit të dokumentacionit në E-prokurim sqaron se, OE ankues në ofertë posedon ISO standardet me validitet dhe sipas kërkesës së AK-së në DT. *(Dëshmitë gjenden në ofertë, faqe Certifikatat ISO pdf)* Pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues kundër OE të rekomanduar:

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson kërkesën lidhur me ekspertët e kërkuar, për arsye se OE i rekomanduar ka ofruar një ekspert për katër kërkesat.

(vërejtje: pretendimin ankimor të plotë e gjeni tek depozitat ligjore dhe pretendimet ankimore të OE ankues lartë në raport të ekspertit)

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues kundër OE të rekomanduar

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues kundër OE të rekomanduar sqaron se, AK në DT ka kërkuar ekspertë ndaras si kërkesa me shkronja C, D, DH duke kërkuar të dëshmohen me certifikata. Rrjedhimisht, duke qenë se ekspertët kanë fusha specifike dhe kërkojnë si staf për detyra specifike, atëherë me qëllim që të respektohen parimet e Ligjit për Prokurim Publik, AK ka ndarë, mirëpo nuk është e pa pranueshme edhe nëse posedon vetëm njëri inxhinier tri fusha si ekspert, të cilat sipas ekspertës shqyrtuese nuk konsiderohet konflikt në orar ose pozita të punës. Pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues kundër OE të rekomanduar:

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar ka bashkangjitur një DUD doganor i cili nuk është në emër të huadhënësit.

(vërejtje: pretendimin ankimor të plotë e gjeni tek depozitat ligjore dhe pretendimet ankimore të OE ankues lartë në raport të ekspertit)

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues kundër OE të rekomanduar

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues kundër OE të rekomanduar sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduar gjendet marrëveshja e noterizuar me nr.2870 dhe 724, për pajisjet makineri, ku DUDI me nr. R37371 figuron se është në emër të Bankës OTR Albania SHA, dhe jo në emër të qiradhënësit, mirëpo AK në rivlerësim konform nenit 72 të LPP-së mund të kërkojë sqarime lidhur me faturën dhe procedurat e blerjes. Pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

(vërejtje: lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë parashtruar dy ankesa 651/25 dhe 652/25 andaj rivlerësimi vie bazuar në dy ankesat e shqyrtuara)

Lidhur me pretendimet e OE TSR SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/652 kanë vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Sinjalizimi vertikal dhe horizontal” me nr. të prokurimit: "VU644-25-3798-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E VUSHTRISË, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, në të cilin vendim OE ankues është shpallë i pasuksesshëm.

Tu je, OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK ofertat ka vlerësuar në kundërshtim me nenet: 59.4 të Ligjit për Prokurim Publik si dhe nenin 41 par.5 dhe par. 6 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022.

Në ankesë janë parashtruar pretendimet ankimore kundër operatorit ekonomik (OE) të rekomanduar.

Pretendimi i parë i OE ankues kundër OE të rekomanduar:

TENDERUESI I REKOMANDUAR “TRAFFIKS VA SHPK” KA OFERTUAR ME ÇMIME JONORMALISHT TË ULËTA (te sit. A poz. 3, 4, 5, 6,7 dhe te sit. B poz. 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12).

(vërejtje: pretendimin ankimor të plotë e gjeni tek depozitat ligjore dhe pretendimet ankimore të OE ankues lartë në raport të ekspertit)

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues kundër OE të rekomanduar

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në platformën E-prokurim, ekspertja shqyrtuese sqaron se, në përputhje me nenin 61 të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenin 41.1 të Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022, Autoriteti Kontraktues (AK) ka diskrecionin për të analizuar dhe hulumtuar tregun në lidhje me çmimet. Për fakti se, sipas analizës së çmimeve për të gjithë ofertuesit, ekzistojnë dallime të konsiderueshme në çmime. Prandaj, si e tillë mbetet në kompetencë të AK-së që të vlerësojë këto çmime krahasuar me çmimet e tregut. Si rezultat, pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues konsiderohet pjesërisht i bazuar.

Neni 41 RRPP nr.001/2022:

41.1 Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës.

Pretendimi i dytë i OE ankues kundër OE të rekomanduar:

Pretendimi nr. 2 – kërkesa 8 e DT është si vijon “Katalogu i produkteve i cili duhet të jete i njëjti nga autorizimi origjinal i prodhuesit apo distributorit të autorizuar“. Tenderuesi i rekomanduar nuk e ka dorëzuar katalogun origjinal të produkteve të prodhuesit por e ka dorëzuar një katalog

të hartuar vet kinse të përkthyer. Në këtë rast OE është dashur që të dorëzoj përpos versionit të përkthyer edhe katalogun origjinal për të konfirmuar nëse përkthimi është autentik. Në të kundërtën katalogu i dorëzuar nga OE në versionin siç është nuk e përmbush kërkesën e DT sepse nuk konfirmon nëse katalogu është sipas prodhuesit të autorizuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues kundër OE të rekomanduar

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankues kundër OE të rekomanduar sqaron se, Autoriteti Kontraktues në dosje të tenderit ka kërkuar:

Kërkesa 8 Katalogu i produkteve i cili duhet të jete i njejt nga autorizimi original i prodhuesit apo distributorit te autorizuar

Dëshmia: Duhete te jete i njejt nga autorizimi original i prodhuesit apo distributorit te autorizuar.

Ndërsa në ofertën e të njëjtit gjenden dy katalog, njëri i cili është për sinjalizim horizontal në gjuhën angleze i cili katalog nuk ka nevojë të përkthehet, si dhe katalogu për sinjalizim vertikal i kontestuar nga OE ankues i cili katalog nga gjuha Italiane është përkthyer nga përkthyesi gjyqësor me vulë, në mënyrë që mos të ofrohet jashtë gjuhëve zyrtare konform Ligjit për gjuhën zyrtare. Pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar për faktin se e njëjta mund të plotësohet si dëshmi.

(vërejtje: lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë parashtruar dy ankesa 651/25 dhe 652/25 andaj rivlerësimi vie bazuar në dy ankesat e shqyrtuara)

-Seanca shqyrtuese-

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues vlerëson se ekspertit shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e OE ankues "ITK" SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues i ka mbështetur konstatimet e ekspertit shqyrtues të dhëna në raportin e ekspertizës, por Paneli Shqyrtues nuk pajtohet me ekspertin shqyrtues i cili potencon se "konform nenit 72 të LPP-së mund të kërkoj sqarime lidhur me faturën dhe procedurat e blerjes lidhur me marrëveshjen e noterizuar me nr.2870 dhe 724, për pajisjet makineri, ku DUDI me nr. R37371 figuron se është në emër të Bankës OTR Albania SHA, dhe jo në emër të qiradhënësit", ngase, marrëveshja si e tillë administrativisht nuk është e vlefshme dhe secila kërkesë e AK për sqarime shtesë bien në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 2 të LPP-se, citat: *"Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues osjetë ofrohen nga një tenderues"*, po ashtu, do të binte ndesh edhe me nenin 72 paragrafi 3 i LPP-se citat: *"Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive"*, kështu që kjo marrëveshje nuk është dokument që mund të kërkojen informacione shtesë ngase nuk mund të sjellët ndonjë marrëveshje tjetër e cila nuk i përmban të gjitha kushtet e nenit 72.3 të LPP dhe çdo ndryshim material është i papranueshëm në një procedurë të prokurimit dhe pikërisht për këtë KRPP me dt. 30.12.2022 (vendim i cili është i publikuar në platformën e e-prokurimit), ka shqiptuar vërejtje ndaj Komunës së Suharekës e cila ka kërkuar sqarime pikërisht për këtë lloj dokumente (lidhur me marrëveshjen të tilla) të cilat nuk mund të përmbajnë datë të fikësuar para skadimit të afatit për dorëzim të tenderëve. Si përfundim Paneli Shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar dhe OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofertuar konform kërkesave të DT.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues vlerëson se ekspertit shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e OE ankues "TSR" SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues i mbështet konstatimet e raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorëve ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara, sepse OE me të vërtet përmban çmime të cilat në dukje janë mjaft të ulëta dhe nuk janë çmime në harmoni me çmimet e tregut. Po ashtu, edhe sa i përket katalogut të ofruar të përkthyer në gjuhën shqipe nuk shihet se është një katalog origjinal dhe i mirëfilltë nga prodhuesi ashtu sikurse është kërkuar me Dosje të Tenderit.

Vlenë të theksohet fakti se edhe autoriteti kontraktues në përgjigje ndaj këtyre dy raporteve të ekspertizave është përgjigjur se pajtohet me vlerësimin e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesat e operatorëve ekonomik me nr. 2025/0651 dhe nr. 2025/0652 i sheh si pjesërisht të bazuara. Rrjedhimisht, anulon njoftimin mbi vendimin e AK të iniciuar nga Komuna e Vushtrri , lidhur me aktivitetin e Prokurimit “Sinjalizimi vertikal dhe horizontal” me nr. të prokurimit: VU644-25-3798-1-1-1, dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Përshtak se AK nuk ka bërë vlerësim të ofertave konform nenit 59 dhe 60 të LPP.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues janë të qëndrueshme ashtu siç janë dhënë në konstatimin e panelit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 1 dhe 4 të LPP-së, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË, KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - I.T.K. SH.P.K., TSR SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: